

Raporti i Audituesit te Pavarur

Per te ardhurat dhe shpenzimet e fushates te Partise Demokracia Sociale per zgjedhjet e 28 Qershorit 2009.

Komisionit Qendror te Zgjedhjeve Tirane

Te nderuar zoterinj!

Ne kemi audituar pasqyren bashkalidhur te fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera nga Partia "Demokracia Sociale" per fushaten zgjedhore te 28 Qershorit 2009. Kjo pasqyre eshte pergjegjesi e drejtimit te Partise "Demokracia Sociale". Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi kete pasqyre bazuar ne auditimin tone.

Ne e kryem auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit (SNA). Keto standarte kerkojne, qe ne te planifikojme dhe te kryejme auditim per te zoteruar siguri te arsyeshme, se kjo pasqyre nuk permban anomali materiale. Auditimi perfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, te fakteve qe mbeshtetin shumat dhe deklarimet ne pasqyren financiare. Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin e parimeve te kontabilitetit te ndjekura dhe vleresimet e rendesishme te bera nga Drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyres se te ardhurave dhe shpenzimeve per nje qellim specifik. Ne cmojme se auditimi yne perben nje baze te arsyeshme per te shprehur nje opinionin tone.

Politika kontabile e ndjekur nga ana e shoqerise eshte te pergatise pasqyren bashkelidhur mbi bazen e fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te realizuara gjate periudhes se fushates zgjedhore. Mbi kete baze, fondet e perfituara njihen kur fitohen ne lek ose ne materiale dhe sherbime te konvertuara dhe shpenzimet njihen si te tilla ne momentin qe ato jane kryer dhe jo kur ato paguhen.

Bazuar ne auditimin e kryer, **me siguri te arsyeshme shpreh opinionin se pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve te fushates zgjedhore te Partise Demokracia Sociale jep nje pamje te vertete e te sinqerte te te ardhurave te realizuara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore per Kuvendin e Shqiperise me daten 28 Qershor 2009.**

Eksperti Kontabel i Regjistruar

Stavri PRIFTI Nr LIC 110

Data 31.10.2009

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve per fushaten e zgjedhjeve te dates 28 Qershor 2009

Te Ardhurat:

-Finacime nga buxheti	2.1921.632	leke
-Nga burimet e vet Partise	8.292.184	leke
-Nga donacionet		
Totali	10.484.814	leke

Shpenzimet:

-Marrje salla me qera	127.880 leke
-Reklama televizive	617.300 leke
-Reklama ne radio	-
-Shpenzime telefonike	764.865 leke
-shpenzime per postera,flet volante, flet palosje etj.	2.233.012 leke
-Shpenzime per kanceleri	25.065 leke
-Shpenzime per karburant	293.230 leke
-Shpenzime per paga e sig.shoqerore	845.000 leke
-Shpenzime tjera te ndryshme	581.362 leke
-Financime Degve dhe Kandidateve ne rrethe	4.997.100 leke
Totali i shpenzimeve	10.484.814 leke

I. Te Pergjithshme

Fushata zgjedhore per zgjedhjet e Kuvendit te Shqiperise ka filluar me 25 Maj 2009 dhe ka mbaruar me 28 Qershor 2009. Aktiviteti financiar ne sherbim te kesaj fushate shtrihet ne nje periudhe me te gjate se ky kufi zyrtar. Per Partine Demokracia Sociale periudha financiare e fushates zgjedhore shtrihet ne muajet Maj-Qershor-Korrik.

Ne pajtim me parimin e kujdesit, te ardhurat jane evidentuar e deklaruar me arketimet faktike, kurse shpenzimet jane evidentuar e deklaruar ne perputhje me kontabilitetin e angazhimeve, d.m.th ne mvartesi nga momenti i njohjes se detyrimit ose shpenzimit te kryer, pavaresisht nga koha e pageses se tyre. Ne koherence me kete ne kontabilitetin e Partise Demokracia Sociale jane evidentuar dhe deklarohen si shpenzime edhe disa fatura te pa paguara deri 28.06.2009, por qe jane paguar ne 10 diteshin e pare te muajit Korrik.

Sipas ketij kuadri konceptual te te ardhurave dhe shpenzimeve, gjate auditimit u muaren ne konsiderate ngjarje dhe fakte ekonomike e financiare qe i takojne fushates zgjedhore 2009.

- Burimet financiare te Partise jane:
 - Te ardhurat nga kuotizacionet
 - Te ardhurat nga buxheti i shtetit ne perputhje me legjislacionin per financimin e partive politike
- Selia e Partise eshte ne Tirane, ne Bulevardin "Zog I"

II. Rregullat e Vleresimit

Menyra e pregatitjes se Pasqyrave Financiare

Kontabiliteti eshte i ndertuar mbi bazen e parimeve te konstatimit. Sipas kesaj menyre fondet e perfituara ne te holla jane regjistruar ne momentin e arketimit te tyre dhe fondet e perfituara ne forme materiale dhe sherbimi ne mometin e kryerjes duke i konvertuar ne vlere leku dhe shpenzimet jane pasqyruar ne momentin e konstatimit te tyre kur jane kryer.

Monedha Raportuese

Partia ka perdorur ALL si monedha baze e raportimit. Fondet e perfituara jane mare ne leke . Shpenzimet jane kryer ne ALL

Taksat dhe Kontributet

Partia eshte e perjashtuar nga taksat mbi fitimin. Partia i ka shlyer detyrimet qe lindin per Sigurimet shoqerore dhe shendetesore te punonjesve dhe per tatimin mbi te ardhurat personale.

1. FONDET E PERFITUARA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2009.

1.1 FONDET PUBLIKE

Me daten 23.06.2009 jane kaluar ne llogarine e PDS prane Raiffeisen Bank nga Dega e Thesarit Tirane shuma 2.192.632 leke si shtese fondi per fushaten zgjedhore ne mbeshtetje te shkreses 6883/1, date 17.06.2009.

Ndersa nga gjendja e trasheguar per shumen 8.292.184 leke ,Partia Demokracia Sociale i ka kursyer nga shumat qe ka perfituar nga financimet e mepareshme nga buxheti i shtetit ne baze te ligjit dhe perputhet dhe me gjendjen qe ka ne llogarine rrjedhese ne Banke.

2. SHPENZIMET E KRYERA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2009

Marrje salle me Qera..

-Qera salla Tirana Int.	77.880 leke
-Qera salla TOB	45.000 leke
-Qera salle Sarande	5.000 leke

2.2 REKLAMA TELEVIZIVE DHE TRANSMETIME SPOTESH

2.2.1 Me televizionin 6+1	130.000 leke
2.2.2 Me televizionin News 24	279.300 leke
2.2.3 Me R.televizionin Saranda	20.000 leke
2.2.4 Me televizionin Dibra vizion	160.000 leke
2.2.5 Tele Joni	20.000 leke
2.2.6 Te tjera	8.000 leke

2.4 SHPENZIME TELEFONIKE 764.865 leke

2.5 SHPENZIME PER FLETEVOLANTE, FLETEPALOSJE, REKLAMA, BANDEROLA

2.5.1 Gjithsej keto shpenzime jane 2.233.012 leke.

2.6 SHPENZIME KANCELARIE 25.065 leke

2.6.1 .

2.7 MESAZHE PROMOCIONALE,

2.8 KARBURANTE bere ne baze te nje plani te miratuar per levizjen e mjeteve gjate fushates.

2.9 Keto shpenzime jane ne shumen 293.230 leke

2.9 ENERGJIA ELEKTRIKE

2.10 PAGAT E PUNONJESVE DHE KONTRIBUTET.

2.10.1 Pagate e punonjesve te muajit Maj dhe Qershor 2009 ne vleren 845.000 leke jane konsideruar si shpenzime te fushates zgjedhore 2009.

- Persa i perket financimeve qe Partia Demokracia Sociale I ka bere Degeve te saja dhe Kandidateve te vet ne Qarqe dhe Rrethe te vendit,keto financime jane bere me vendim te

Kryesise se kesaj Partie,u jane dhene me mandat pagese te rregullt,por per keto nuk disponohen dokumente te tjera justifikuese per llojin e shpenzimit te kryer. Keto financime jene ne shumen prej 4.997.100 leke.

LLOGARITE BANKARE .

Gjendja e likuiditeteve ne banke 28.06.2009, **eshte e ndare si me poshte:**

	<u>Gjendja ne Leke</u>
Para ne arke	-
Banka	2.955.013,94 leke
Banka	-
TOTALI	2.955.013,94 leke

Partia Demokracia Sociale gjate fushates 2009 ka operuar vetem ne nje llogari bankare prane Tirana Bank ne ALL.

5. REGJISTRIMI I FONDEVE JOPUBLIKE

Regjistrimi i fondeve jopublike te perfituara gjate fushates zgjedhore 2009 eshte bere ne regjistrin e posaqem, sipas modelit te miratuar me vendim te KQZ-se ,por Partia Demokracia Sociale nuk ka perfituar donacione dhe kete regjister e ka paraqitur me zero.

Shpenzimet totale qe ka kryer PDS-ja per fushaten zgjedhore nuk e kalojne kufirin e percaktuar ne nenin 90 te ketij ligji. Te gjitha shpenzimet e kryera gjate fushates zgjedhore jane dokumentuar duke respektuar legjislacionin tatimor ne fuqi.

Ne keto pasqyra jane perfshire te gjitha fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera nga PDS-ja ne qender dhe ne qarqe.

6. NGJARJE TE MEVONESHME

Nuk ka patur ngjarje te mevoneshme qe mund te influencojne ne pasqyrat financiare te mesiperme.

Ne perfundim,bazuar ne auditimin e kryer sipas standartit nderkombetar per qellime te vecanta,me siguri te arsyeshme shpreh opinionin se pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve te fushates zgjedhore te Partise Demokracia Sociale jep nje pamje te vertete e te sinqerte te te ardhurave te realizuara dhe shpenzimeve te kryera per kete fushate per zgjedhjet per Kuvendin e Shqiperise me daten 28 Qershor 2009.

Stavri PRIFTI

Ekspert Kontabel i Regjistruar

Tirane, me 31 Tetor 2009